



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 9

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, datë 26 shkurt 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 3523, datë 20.2.2018	Për shitje me ankand të objektit në administrim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë..... 3
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 897/3, datë 22.2.2018	Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës, “Hartimi i Strategjisë së Komunikimit, përfshirë planin e veprimit të fushatës dhe zbatimi i aktiviteteve të fushatës së komunikimit për reformën e PAK-së”, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 4
Njoftim i Presidentit të Republikës nr. 574, datë 23.2.2018	Për shpalljen e vendit vakant pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit... 6



NJOFTIM

Nr. 3523, datë 20.2.2018

PËR SHITJE ME ANKAND TË OBJEKTIT NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË
FINANCIVE DHE EKONOMISË

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, pika 16, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + truall)	Mjetet kryesore	Truall			Data	Ora	Vendi
1.	Objekti me nr. pasurie 1054 (i ish-Repartit 101/K), në zonën kadastrale 2807, në fshatin Nivicë, Tepelenë	Nivicë, Tepelenë	1 352 402	1224 902	127 500	1 020	373	5.3.2018	14:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, në datën dhe në orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesë apo garanci bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë në vendin, në datën dhe në orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesë apo garanci bankare që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe

Ekonomisë, në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. Vendim i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. Dëshmi të trashëgimisë, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.

5. Deklaratë noteriale, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe, faturën



për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financa.gov.al

KËRKESË

897/3, datë 22.2.2018

**PËR SHPREHJE INTERESI
PËR SHËRBBIMIN E KONSULENCËS
“HARTIMI I STRATEGJISË SË
KOMUNIKIMIT, PËRFSHIRË PLANIN E
VEPRIMIT TË FUSHATËS DHE
ZBATIMI I AKTIVITETEVE TË
FUSHATËS SË KOMUNIKIMIT PËR
REFORMËN E PAK-së”, PËRFITUES I
SË CILËS ËSHTË MINISTRIA E
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE**

Ref. no. SAMP/CS/QCBS/14-2016

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale - SAMP

Hua nr.: 8141-AL

Nr. i identifikimit të projektit: P122233

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës lokale (shërbim) përfshin: **“Hartimi i strategjisë së komunikimit, përfshirë planin e veprimit të fushatës dhe zbatimi i aktiviteteve të fushatës së komunikimit për reformën e PAK-së”**.

Në bashkëpunim të ngushtë me dhe nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në MSHMS (e cila është agjencia zbatuese për SAMP-në), kompania konsulente do të jetë përgjegjëse për hartimin e strategjisë së komunikimit, duke përfshirë edhe planin e veprimit të fushatës dhe implementimin e aktiviteteve të komunikimit të propozuara në planin e veprimit të strategjisë së komunikimit, për të promovuar ndërgjegjësimin, kuptimin dhe pranimin e reformave për programin për personat me aftësi të kufizuara (PAK).

Konsulentët i pritët të jetë i specializuar në planifikimin, në hartimin dhe në zbatimin e

aktiviteteve të mëdha të komunikimit; të ketë njohuri dhe përvojë mbi metodat dhe mjetet e komunikimit; aftësinë për të zhvilluar produkte të komunikimit; të mund të kryejë role këshilluese; dhe të ofrojë shërbime që lidhen me shpërndarjen dhe përhapjen e informacionit (të tilla si media elektronike të shkruara dhe prodhimin dhe shpërndarjen, aplikacioneve *web-bazuar*, ngjarje publike etj.), duke përfshirë dhe mbështetjen logjistike. Kohëzgjatja e kontratës është parashikuar të jetë rreth 6 muaj, sipas standardit *lump-sum*.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP), fton të gjitha kompanitë e konsulencës legjitime (konsulente) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.

Konsulenti i suksesshëm duhet të ketë demonstruar përvojë në fushën e zbatimit të aktiviteteve të komunikimit.

Kompania konsulente do të jetë një firmë e cila posedon departamente organizative, të reklamave dhe marrëdhëniet me publikun, të mirëorganizuar dhe duhet të ketë stafin e mëposhtëm në dispozicion për këtë detyrë, si drejtues ekipi, projektues profesional, ekspert për prodhimin e ngjarjeve vizuale, ekspert për dizajnimin e *Web*, ku të gjithë kërkohet të kenë përvojë të gjerë profesionale në tregun lokal ose atë rajonal.

Kriteret e shortlistimit janë:

1. Objekti i biznesit dhe vitet në biznes	20 pikë
2. Kualifikimet ose eksperiencia specifike e firmës në ekspertizën sociale	40 pikë
3. Organizimi teknik dhe menaxherial i firmës	10 pikë
4. Kualifikimet e përgjithshme dhe numri i stafit kryesor	30 pikë
TOTALI	100 pikë

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore, për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA & grante nga huamarrësit e Bankës Botërore* (Udhëzuesi i konsulencës), version i janarit të 2011-ës.



Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një *joint venture* apo në formën e nënkontraktimit për të rritur kualifikimet e tyre.

Një firmë konsulente do të përzgjidhet në përputhje me metodën: “Përzgjedhje sipas cilësisë dhe kostos (QCBS)”, në përputhje me procedurat e udhëzuesve të Bankës Botërore për përzgjedhjen e punësimit të konsulentëve (botimi i janarit 2011).

Firmat të cilat kanë shprehur interes gjatë publikimit të parë, nuk është e nevojshme të përsërisin aplikimin e tyre. Prezantimi i tyre do të merret në konsideratë gjatë vlerësimit të shprehjeve të interesit.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme, gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me *e-mail*) deri më **6 mars 2018**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Rruga e Kavajës, AL-1001, Tirana, ALBANIA

Në vëmendje të znj. Suzana Papadhopulli

e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

**REQUEST
FOR EXPRESSION OF INTEREST
CONSULTING SERVICES
FOR**

**“Design of Communications Strategy,
including the Campaign Action Plan, and
Implementation of Communications
Campaign Activities for Disability Assistance
reform” - Consultant Company
Ref. no: SAMP/CS/QCBS/14-2016**

Albania

Social Assistance Modernization Project - (SAMP)

Loan No.: 8141- AL

Project ID No. P122233

The Republic of Albania, has received financing from the World Bank toward the cost of the Social Assistance Modernization Project (SAMP), and

intends to apply part of the proceeds for consultant services. The consulting services (“the Services”) include **“Design of Communications Strategy, including the Campaign Action Plan, and Implementation of Communications Campaign Activities for Disability Assistance reform”**.

In close collaboration with and under direct supervision of Department of Health and Social Protection development Programs within MHSP (which is the implementing agency for SAMP), the consultant firm will be responsible for designing the Communications Strategy, including the campaign action plan, and implementing the communications activities proposed in the action plan of Communications Strategy, to promote awareness, understanding and acceptance of the reforms in Disability Assistance (DA) program.

The Consultant is expected to be specialized in planning, designing and implementation of major communications interventions; has knowledge and experience of communication methods and tools; have the ability to develop communication products; can perform advisory roles; and provide services related to information dissemination and sharing (such as print and electronic media production and delivery, web-based applications, public events, etc) including the logistic support. The contract duration is expected to be for approximately 6 months, under a lump-sum payment.

The Ministry of Health and Social Protection through Project Management Team (PMT) now invites eligible local consulting firms (“Consultants”) to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The successful consultant should have demonstrated experience in the field of implementation of communication activities.

The Consultant will be a firm which possesses well established advertising, public relations and organizational departments and should have the following staff available for this assignment such as Team leader, professional designer, expert for production of visual events, web designer expert, all with extensive professional experience in the local or regional market.



The short listing criteria are:

1. Core business and years in business	20 points
2. Qualifications or Specific experience of the firm in the social area expertise	40 points
3. Technical and managerial organization of the firm	10 points
4. General qualifications and number of key staff	30 points
TOTAL	100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: *Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers* ("Consultant Guidelines") - January 2011, setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

Consultants may associate with other firms in the form of a joint venture or a sub consultancy to enhance their qualifications.

A Consultant Firm will be selected in accordance with the Quality- and Cost-Based Selection of Consultants (QCBS) method set out in the World Bank's Guidelines: *Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers* (edition of 2011).

Firms which submitted expressions of interest during the first publication need not to apply. Their submission will be considered in the evaluation of expressions of interest

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by fax, or by e-mail) by **March 6, 2018**.

Project Management Team (PMT)
Social Assistance Modernization Project (SAMP)

Ministry of Health and Social Protection
Rruga e Kavajës, AL-1001, Tirana, ALBANIA

Att: Suzana Papadhopulli

e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

NJOFTIM

Nr. 574, datë 23.2.2017

PËR SHPALLJEN E VENDIT VAKANT PRANË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit":

I. Rishpall 1 (një) vend vakant për pozicionin e "Përkthyesit".

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

a) Të zotërojë diplomë të nivelit master shkencor në Gjuhë të Huaja, dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimumi 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip-Anglisht-Shqip.

b) Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.

c) Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

KUSHTET TË PËRGJITHSHME

- Kandidati duhet të sigurohet se plotëson kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Kandidati duhet të ketë aftësi për t'u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 mars deri më 16 mars 2018, në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e hëna në të premte, ora 09:00-16:00.**

- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 16 mars 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletëmandatin e lëshuar



nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

- **Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike** nga data **12 mars deri më 16 mars 2018**, në adresën: info@kpa.al. KPA-ja konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

2. Kopje të dokumenteve (diplomë, letër-njoftim (ID), librezë pune) origjinal ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;

4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;

5. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

6. Vlerësim të fundit nga eprori direkt;

7. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.